



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:153954
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05470330

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.646/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit E. B. për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1259/22 të datës 28.07.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 15.03.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, dhe të pandehurit E. B. me datë 15.03.2024 shpalli ndërsa me date 19.03.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

E. B. , i lindur me, në Gjermani, nga i ati N.... dhe A....., e vajzërisë L., në Pejë, banon në "S. H." te D., ka të kryer dhjetë klasë, pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikohet në bazë të nr. personal, Shqiptar, shtetas i R. së Gjermanisë.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën: 15.12.2021 në Pejë rreth orës 17:10 h në Rr. T. B. ka poseduar pa autorizim narkotikë të llojit M. në sasi prej 0.8 gram neto në atë mënyrë që: në kohën dhe vendin e lartëcekur gjersa njësitit i hetimeve i policisë ishte duke patrulluar në këmbë e vëren të pandehurin E. i cili ishte ulur në një cep të rrugës dhe ishte duke bërë disa lëvizje të dyshuara dhe pas legjitimitit dhe kontrollimit fizik të tij në xhepin e ti të djathtë policia gjejnë një sasi të dyshuar të narkotikut në dy qese plasmasi (D#3 dhe D#4) e cila substancë pas ekzaminimit me datën 16.12.2021 përmes

NAR Test NTX 2000 ka rezultuar POZITIVE se është substancë narkotike e llojit MARIHUANË në sasi të përgjithshme prej 0.8 gram neto,

- me çka ka kryer veprën penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substanca psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit E. B. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës dhe te njëjtat mbeten ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.
- III. Substanca narkotike e gjetur te i pandehuri konfiskohet.

ARSYETIM

- A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 28.07.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1259/22 kundër të pandehurit E. B. për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 15.03.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokuroja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, dhe i pandehuri E. B. , në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit, duke vendosur në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi “ Meqenëse i akuzuar e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe një gjë të tillë e bere konform kushteve ligjore te parapara me neni 242 te KPPRK-se dhe ne përputhje te plote me te gjitha provat materiale dhe personale në te cilat mbështettë kjo aktakuze , nga gjykata kërkoj qe te njëjtin ta shpalle fajtor ta dënoj sipas ligjit dhe te obligoj ne paguarjen e shpenzimeve te procedurës penale, ndërsa ne rastin e përcaktimit ne llojin dhe lartësinë e dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethane lehtësuese”.

I pandehuri E. B. deklaroi “Më vjen shumë keq për këtë rast që ka ndodhë, Nuk kam diçka tjetër për të shtuar”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074)dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese te çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Përcaktimi i dënimit me burgim prej 6 (gjashtë) muajsh u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në

këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale të kryer nga i pandehuri është dënimi me burgim prej gjashtë muaj¹.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej një viti do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është parapare mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë

¹ Udhëzues për Politiken Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës, fq 201.

kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori duke u bazuar ne fakti se i pandehuri jeton ne kushte te vështira ekonomike përkatësisht është përfitues i ndihmës sociale, çka e vërteton me certifikatën e ndihmës sociale te lëshuar nga Republika Federale e Gjermanisë, Zyra e Gjendjes civile Standesamtsbehör nr.G te datës 10.05.2021, me çrast e pandehura u lirua nga shpenzimet e procedurës te cilat mbeten ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës ne bazë te nenit 452 par.4 te KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike e cila ka qenë objekt i kryerjes së kësaj vepre penale, u morr në kuptim të nenit 269 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par. 1 dhe 2 nën par. 2.4 të KPPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.646/22, me datë 19.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.